



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. /2026

Dt.06.01.2026

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 51 dhe nenit 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 38 dhe 40 të Statutit të Komunës së Gjakovës, nenin 6 paragrafët 7 dhe 8 të Ligjit Nr.05/L-020 për Barazi Gjinore, nenin 3, nenit 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.05/2020, për Procedurat e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve të tjera në Komunë, në mbledhjen e mbajtur me datë 06.01.2026, pas diskutimit lidhur me pikën e 4-të të Rendit të Ditës: Themelimi i Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Gjakovës, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komitetit për Komunitete i Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me këtë përbërje:

1. z. Artan Berisha, përfaqësues i Komunitetit Egjiptian.
2. z. Xhavit Rexhaj, përfaqësues i Komunitetit Egjiptian.
3. znj. Floriana Dana, përfaqësuese e Komunitetit Ashkali.
4. z. Emrah Cermjani, përfaqësues i Komunitetit Rom.
5. znj. Ifeta Jakupi, përfaqësuese e Komunitetit Boshnjak.
6. z. Nik Hiseni, përfaqësues i Kuvendit të Komunës.
7. znj. Shqipe Fejza, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës.
8. znj. Kllara Nikollbibaj, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës.
9. z. Kujtim Golaj, përfaqësues i Kuvendit të Komunës.

2. Kompensimi i anëtarëve të këtij komiteti që nuk janë zyrtar Publik të bëhet nga kategoria Mallra dhe Shërbime nga zyra e Kuvendit të Komunës ekuivalent me pagesën e anëtarëve tjerë që janë zyrtar Publik (anëtar të Kuvendit) në masën 30% të pagës së Anëtarëve të Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.

4. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini .
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Anëtarëve të Komitetit për Komunitete.
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës .
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.
- Arkivit.



Kryesues i Kuvendit të Komunës

z. Shefqet Shehu